



Planimat / Dateduar Prijemna / Prilazno Kosovo / Prijava	26.12.2023	3	vet opis list
Organ / Institucija Org / Inst	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. / Inj.	Shtet / a Parti / g Zyrtar / e	Sasia Koliciteti Quantity
SKMSTK	7673/2023		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1396/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1396/2023 të datës 09.11.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati kundër Vendimit me numër RN00012150/02 të datës 13.10.2023 të Komisionit për pranim në Komunën e Prizrenit, në çështjen juridike "Kontestimi konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1396/2023 e datës 09.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr. RN00012150/02 i datës 13.10.2023 i Komisionit të pranimit në Komunën e Prizrenit.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 38 paragrafin 1,2,3,4 si dhe nenin 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, më datë 26.07.2023 ka publikuar konkursin me numër reference Nr. RN00012150 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës „ Zyrtarë i Lartë për Politika Rinore” në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prizrenit ku afati për aplikim ka qene nga data 10.08.2023 deri më 17.08.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar katër (4) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili i është nënshtruar të gjitha fazave të procedurës.

Në bazë të njoftimit të datës 23.08.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore për verifikim paraprak për procedurën „Lëvizje Brenda Kategorisë“ ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë dhe ka fituar të drejtën e konkurrimit në këtë procedurë. Ndërsa më datë 02.10.2023 pas zhvillimit të intervistës, Menaxheri i Burimeve njerëzore në Komunën e Prizrenit ka nxjerrë njoftimin me numër Nr.RN00012150/01 për renditjen përfundimtare përmes së cilit ankuesi nga ky proces i pranimit ka marrë gjithsejtë katër dhjetë e gjashtë e gjashtë (46.6) pikë.

Ankuesi kundër këtij njoftimit me numër Nr.RN00012150/01 më datë 07.10.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prizrenit, ndërsa më datë 13.10.2023 Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë ka nxjerrë Vendim me numër Nr.RN00012150/02 përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi, me arsyetimin se ankuesi nuk është përgjigjur saktë në pyetjet e parashtruara nga kryetari i komisionit të vlerësimit e gjithashtu edhe përgjigjet e dhëna në pyetjet e anëtareve të tjerë të komisionit janë të gabuara.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.RN00012150/02 të datës 13.10.2023, të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prizrenit, më datë 09.11.2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat _____ ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6949/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit në Komunën e Prizrenit. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit më datë 01.12.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me nr. Protokoli 6949/2023 të parashtruar me datë 09.11.2023 nga ankuesi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar _____ në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin e Pavarur të Kosovës; Aktemërimin me numër reference Nr.Ref.2630/2019 të datës 27.06.2019; Konkursin me numër reference Nr.Ref. RN00012150 të datës 10.08.2023; Njoftimin e datës 23.08.2023 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; Njoftimin e datës 04.09.2023 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; Vendimin me numër Nr.RN00012150/02 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me datë 29.09.2023; Njoftimin me numër Nr.RN00012150/01 të datës 01.10.2023 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; Ankesën e parashtruar me datë 07.10.2023 nga ankuesi në Komisionin për Vlerësim Brenda Kategorisë në Komunën e Prizrenit; Vendimin me numër Nr.RN00012150/02 të datës 13.10.2023 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; Kërkesën për qasjen në dokumente publike të parashtruar nga ankuesi me datë 17.10.2023 në Komunën e Prizrenit; Procesverbalin e datës 06.10.2023; E-mailin e datës 29.09.2023; E-mailin e datës 20.10.2023; E-mailin e datës 31.10.2023; E-mailin e datës 27.10.2023; E-mailin e datës 17.10.2023; Dëshminë nga Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Jetëshkrimi për ankuesin Sh.B; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm,

i ulët dhe professional me numër Nr.296/2022 të datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësëve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional me numër Nr.370/2023-68 të datës 31.01.2023; Vërtetimin me numër Nr. Protokolli 4116/2023 të datës 15.08.2023; Certifikatën me numër Nr.648 të vlefshme për vitet 2019-2021; Aktemërimin me numër Nr. 137 të datës 11.07.2018; Certifikatën me numër 574 të lëshuar në vitin 2022; Diplomën me numër Nr. 134/15 të datës 12.09.2015 të lëshuar nga Kolegji Iliria; Letrën e Referencës me numër reference Ref. 10022016-1 të datës 10.02.2016 të lëshuar nga KAF; Letrën e Rekomandimit të datës 04.01.2017 të lëshuar nga Komuna e Prizrenit/Drejtoria për Ekonomi dhe Financa; Referencën të lëshuar nga Drejtori i Biznesit Individual F.H; Autorizimin e datës 06.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.11.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 01.12.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar për pozitën Zyrtar i lartë për politika rinore; Vendimin me numër Nr. RN00012150/01; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktemërimin të datës 20.06.2016; Aktemërimin me numër AE.Nr. 01-112-118528 të datës 08.08.2022; Aktemërimin e datës 04.01.2012; Aktemërimin me numër AE.Nr.01-112-133636 të datës 01.09.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktemërimin të datës 20.06.2016; Dëshmi me numër reference Nr. Ref. RN00012150; Kopjen e letërnjoftimit me nr. 101047; Pasqyrën e Llogarisë të Trustit Pensional për periudhën kohore 03.03.2016-11.08.2023; Diplomën me numër Nr. 577 të datës 21.03.2019; Vërtetimin me numër Nr.4117/2023 të datës 15.08.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësëve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional me numër Nr.371/2022/04 të datës 03.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë me numër Nr.370/2022/102 të datës 03.02.2023; Kopjen e pasaportës; Aktemërimin me numër reference Nr.Ref. 3022/2020 të datës 08.09.2020; Aktemërimin me numër Nr.3869/2019 të datës 10.09.2019; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër Nr. 2689/2019-2 të datës 01.07.2019; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër Nr.481/2019 të datës 19.02.2019; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër Nr.2448/2018 të datës 19.07.2018; Dëshmi nga Trusti të datës 25.02.2022; Referencën e datës 28.01.2021 të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Pasqyrën e Llogarisë nga Trusti Pensional për periudhën kohore 01.01.2016-01.03.2017; Kontratën e punës për kohë të caktuar/të pacaktuar me numër Nr.8114381185 të datës 15.10.2014; Certifikatën të datave 15,16 shkurt 2022; Certifikatën të datave 8.9 shkurt 2022; Certifikatën të muajit Qershor 2021; Certifikatën për muajin Prill-Maj 2019; Certifikatën me numër Nr.277/19 të datës 23.09.2019; Certifikatën me numër Nr.33/17 të datës 09.05.2017; Certifikatën për muajin Maj 2016; Certifikatën për muajin Gusht 2015; Certifikatën e datës 10.05.2014; Certifikatën me numër Nr.70633426 të datës 15.06.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është *e pabazuar sepse*:

Ankuesi në ankesën me numër protokolli 6949/2023 të parashtruar përfaqësuesit të autorizuar avokat në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.RN00012150/02 të datës 13.10.2023 të Komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë në Komunën e Prizrenit, pretendon se Vendimi i atakuar me ankesë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik, gjithashtu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren



(QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i këshillit konstaton se Komuna e Prizrenit, më datë 26.07.2023 ka publikuar konkursin me numër reference Nr.RN00012150 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën „Zyrtarë i Lartë për Politika Rinore” ku afati për aplikim ka qenë nga data 10.08.2023 deri më datën 17.08.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili sipas Akt Emërimit me numër Nr.2630/2019 të datës 27.06.2019 mbanë pozitën e punës „Zyrtarë i Prokurimit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prizren, ndërsa me rastin e përfundimit të procedurës Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë ka bërë vlerësimin e kandidatëve në këtë proces dhe në bazë të njoftimit me numër me numër Nr.RN00012150/01 të datës 02.10.2023 për renditjen përfundimtare të kandidatëve ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë katër dhjetë e gjashtë (46) pikë, duke u renditur i dyti në listë ndërsa kandidati I.M është vlerësuar me katërdhjetë e shtatë (47) dhe është renditur i pari.

Në bazë të konkursit me numër reference Nr.RN00012150 të datës 26.07.2023 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën „Zyrtar i Lartë për Politika Rinore” në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prizrenit si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve. Fakulteti Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të Punës.*

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me procedurën e rekrutimit të lartcekur, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 38 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: “1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni”, gjithashtu edhe paragrafin 5 dhe 6 ku përcaktohet se: “5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njësisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.”.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

Nenit 44 paragrafi 1 dhe 2, më të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje"

Nenit 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin".

Nenit 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike".

Nenit 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit".

Nenit 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues". Andaj mbi këtë bazë, Kolegji i këshillit konstaton se Komisioni për Vlerësimin e procedurës së rekrutimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, vlerësimin e intervistës me gojë për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në këtë proces e ka bërë në pajtim me dispozitat e lartë cekura e që rrjedhimisht ankuesi nga komisioni është vlerësuar me katërdhjetë e gjashtë pikë gjashtë (46.6) pikë të përgjithshme, në këtë rast referuar dispozitave të lartë cekura ankuesi nuk ka arritur pikët e vlefshme prej gjashtëdhjetë (60) pikë për tu emëruar në pozitën „ Zyrtar i Lartë për Politika Rinore“, ndërsa për sa i përket vlerësimit të kandidatëve në intervistën me gojë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se është vlerësim diskrecional i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, ngase ky vlerësim bëhet në bazë të përgjigjeve të dhëna që benë Komisioni i Vlerësimit gjatë intervistimit të kandidatit kështu që duke marr parasysh faktet e lartpërmendur Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i kandidatëve është bërë në pajtim me Rregulloren Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, konkretisht me nenin 47 ku përcaktohet se: „ 1.KVLBK zhvillon një

intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë", në mbështetje të dispozitave të lartë cekura pretendimi ankimor i ankuesit se i njëjti nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e Komisionit Vlerësues është pretendim i pa bazuar, sepse sipas dëshmisë së bashkëngjitur nga shkresat e lëndës sipas rezultateve të vlerësimit të intervistës me gojë ankuesi është vlerësuar me këto pikë nga anëtarët e komisionit, F.H me pesëdhjetë e tetë (58) pikë, V.Xh shtatëdhjetë (70) pikë, I.G njëzet e pesë (25) pikë, A.V katër dhjetë pikë (40) pikë dhe S.S-K katër dhjetë (40) pikë, andaj mbi këtë bazë edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër Nr.RN00012150/02 të datës 13.10.2023 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prizrenit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky Vendim është nxjerrë në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1396/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.